



Elida Trushoj
Etur



Tajana Xano Sul

Artemido Lucej fuzaj
Ysiola Monopati Ithuj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
REKTORATI

Nr. 878 / Prot.
13

Vlorë, më, 26.04.2023

VENDIM

Nr. 6, datë 24.04.2023

PËR

MIRATIMIN E KORRIGJIMIT TË PROVIMEVE ON-LINE

Mbështetur në nenin 40 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 26 të Statutit të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, në propozimin e Zv. Rektorit për Kërkim Shkencor dhe Zhvillim Institucional, Nr. 733/2,,prot datë 24.04.2023, Rektorati në mbledhjen e tij të dates 24.04.2023,

VENDOSI

1. Të miratojë përcjelljen në SA, për shqyrtim dhe miratim të propozimit: “Në pikën 4 të nenit 89 të Rregullores së Brendshme të UV-së”, të shtohet fjalia: Departamentet përdorin edhe formën elektronike të vlerësimit të përgjigjeve të provimeve me shkrim, të studentëve, në lëndët dhe modulet e përcaktuara dhe miratuara prej tyre.
2. Kjo formë vlerësimi i përgjigjeve me shkrim të studentëve të pasqyrohet në sillabuset përkatëse të lëndëve ose moduleve.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Njësitë Kryesore, Njësitë Bazë dhe Drejtoria e Edukimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

VLORE
Nr. 4533/Prot
2

Vlorë, më 24/04/2023

Lënda: Propozim për korrigjimin e provimeve on-line.

PROF. DR. ROLAND ZISI
REKTOR

KËTU

I nderuar z. Rektor,

Në kuadër të marrveshjes së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë me Albanian-American Development Foundation (AADF) miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 15 datë 31.03.2022, Nr. 479/2 Prot. datë 06.04.2022 "Për miratimin e nënshkrimit të marrveshjes së bashkëpunimit midis Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Albanian American Development Foundation (AADF), në UV ka filluar implementimi i projektit CleanScore. Në zbatim të këtij projekti dhe në bazë të neneve 3.2.4 dhe 3.2.5 të marrveshjes së sipërcituar, UV do të mundësoj "... procedurën alternative të korrigjimit të provimeve nëpërmjet përdorimit të sistemit të integruar teknologjik të CleanScore në vlerësimin e studentëve..." si dhe "...mundëson angazhimin e pedagogëve të lëndëve për realizimin e testeve të studentëve në format me pyetje me alternativa për ato module...". Në bazë të këtyre më lart dhe me qëllim korrigjimin e provimeve on-line nga pjesa e pedagogëve të cilët dëshirojnë të përdorin këtë mënyrë alternative, propozoj një vendimarrje të tillë.

Propozoj që kjo vendimarrje mos të jetë detyruese për të ofrohet si opsion alternativ për stafin akademik.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

Zv. REKTOR

Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli